

VENDIM
Nr.963, datë 2.10.2009

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.486, DATË 25.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT TË
ANIJEVE, QË TRANSPORTOJNË NAFTË, GAZ DHE NËNPRODUKTE TË
TYRE, NË PORTET E DURRËSIT DHE TË SHËNGJINIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 2 e 10 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1 të vendimit nr.486, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Afati i përcaktuar sipas paragrafit të mësipërm shtyhet deri më 30 dhjetor 2009 për përpunimin vetëm të anijeve, që transportojnë nënproduktet e naftës: bitum i lëngët, mazut, solar, vajra lubrifikante, benzinë mjetesh të fluturimit ajror dhe lëndë djegëse për mjetet e fluturimit ajror, reaktive."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha